




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01nr 400-9108

Dt: 18.02.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Përfundimit nr.06-7288-3/1 të miratuar me dt: 09.02.2016 në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, me të cilin është miratuar kërkesa e Organizatës Komunale të Pensionistëve të Komunës së Gjakovës për mbulimin e shpenzimeve për sigurimin e medikamenteve të cilat nuk gjinden në listën esenciale të barnave, me dt: 18.02.2016 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Organizatës Komunale të Pensionistëve të Komunës së Gjakovës për mbulimin e shpenzimeve për sigurimin e medikamenteve të cilat nuk gjinden në listën esenciale të barnave, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione të Zyrës së Kryetares së Komunës në vlerë prej 2,400.00€.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 2,400.00€ nga mjetet e subvencioneve të Zyrës së Kryetares së Komunës dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirologarinë e Organizatës Komunale të Pensionistëve të Komunës së Gjakovës nr.1402000001751173 Banka Ekonomike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
 - Drejtësisë për Shëndetësi dhe Mirëqeni Sociale
 - Z. Ibrahim Rudi, kryetar i Organizatës Komunale të Pensionistëve të Komunës së Gjakovës
 - Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila

